



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
Komuna e Prishtinës  
Pristina Obstina-Municipality of Pristina



**SEKTORI I PROKURIMIT - KABINETI I KRYETARIT**

Bazuar në nenin 108/A paragrafi 10 nënparagrafi 10.2 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik lidhur me nenin 60 të Ligjit nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237 dhe me ligjin nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 61.3. lidhur me nenin 62 paragrafi 62.1 nënparagrafi d) si dhe nenin 63 paragrafi 63.1 nënparagrafi 63.1.1 të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të operatorit ekonomik "Sefedin Heta B.I." të datës 05.11.2024 kundër njoftimit mbi vendimin e datës 31.10.2024 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Deratizimi,Dezinfektimi,Dezinfektimi DDD ne SHPMPF-së" me nr. të prokurimit 616-24-10733-2-3-6, Komuna e Prishtinës (autoriteti kontraktues) përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit nxjerr këtë:

## V E N D I M

- I. **REFUZOHET** kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik "Sefedin Heta B.I." të datës 05.11.2024 kundër njoftimit mbi vendimin e datës 31.10.2024 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Deratizimi,Dezinfektimi,Dezinfektimi DDD ne SHPMPF-së" me nr. të prokurimit 616-24-10733-2-3-6.
- II. **AUTORIZOHET** autoriteti kontraktues - Komuna e Prishtinës që të vazhdoj me aktivitetin e prokurimit të përcaktuar si në pikën I të këtij vendimi.
- III. **NJOFTOHEN** palët e interesuara lidhur me këtë vendim përmes publikimit në platformën elektronike E-Prokurimi në adresën <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

### Arsyetim

Operatori ekonomik "Sefedin Heta B.I." (tutje "parashtruesi") me datë 05.11.2024 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër njoftimit mbi vendimin e datës 31.10.2024 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Deratizimi,Dezinfektimi,Dezinfektimi DDD ne SHPMPF-së" me nr. të prokurimit 616-24-10733-2-3-6.

Gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesës për rishqyrtim të parashtruesit është gjetur se kërkesa është e lejuar dhe është parashtruar brenda afatit nga personi i autorizuar si dhe nuk ekzistojnë pengesa tjera për të shqyrtuar kërkesën e parashtruesit. Në këtë mënyrë janë plotësuar kushtet për të vazhduar me shqyrtimin meritor (*in meritum*) të kërkesës.

Pretendimet ankimore të parashtruesit: "Kemi dal me cmim te njejt me kompanine qe eshte shpallur fitues dhe nuk e kuptojme pse eshte shpall kompania tjeter fituese".

Lidhur me pretendimet ankimore duhet cekur se përmes nenit 39.8 të RRPP është përcaktuar se "Votimi vlen vetëm për kriteret dhe kushtet e përcaktuara në Dosje të Tenderit. në rastet kur Autoriteti Kontraktues pranon 2 (dy) apo me shumë oferta të përgjegjshme me çmime të njëjta (identike) nuk vlen votimi i anëtareve të Komisionit të vlerësimit për përzgjedhjen e OE, por përzgjedhja bëhet sipas kohës së dorëzimit të ofertës (OE i cili e ka dorëzuar ofertën i pari)". Në rastin konkret oferta e tenderuesit të rekomanduar "MEB LLC" është dorëzuar me datë 23.10.2024 në ora 13:26 ndërsa oferta e parashtruesit "Sefedin Heta B.I." është dorëzuar rreth 2 ditë më vonë përkatësisht me datë 25.10.2024 në ora 11:06. Duke u referuar në nenin 39.8 të RRPP është gjetur se të dy ofertat përmbajnë çmime identike prandaj për kontratë është rekomanduar oferta e dorëzuar më herët.


Nga sa u tha më sipër është gjetur se parashtruesi nuk ka paraqitur argumente të qëndrueshme për të mbështetur pretendimet e tij. Prandaj kërkesa për rishqyrtim e parashtruesit është refuzuar si e pabazuar në tërësi.

Për pikën I dhe II të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.1.1. nënparagrafin b) lidhur me nenin 62 par. 62.1. nënparagrafin d) të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik.

Për pikën III dhe IV të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.2. të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik.

Bazuar në të thënat më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**Prishtinë, 07.11.2024**

**Visar SHEHU**  
  
Udhëheqës i Sektorit të Prokurimit  
Komuna e Prishtinës

**Këshillë juridike:**

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të paraqes ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.